



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KOLONJË  
KËSHILLI BASHKIAK

PROTOKOLLI 1

REND-DITE

1. Miratimi i Rendit të ditës së Mbledhjes, sipas nenit 53, pika 5, ligji 139/2015.
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së datës 22.12.2025 të Këshillit Bashkiak dhe njohje me shkresën e zbardhjes së vendimeve nga institucioni i prefekturës.
3. **Projekt-Vendim** “Për miratimin e ndihmës ekonomike familjeve që janë larguar nga sistemi i pikëzimit për muajin Dhjetor 2025, që nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme nga fondi i kushtëzuar për bllok ndihmën deri 6%.”
4. **Projekt-Vendim** “Për miratimin e kriterëve për familjeve në nevojë që të trajtohen me ndihmë ekonomike nga përdorimi i fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar të bllok-ndihmës deri në 6%.”
5. **Projekt-Vendim** “Për miratimin e raportit të vlerësimit dhe parashikimit afatmesëm të të ardhurave për PBA 2027-2029.”
6. **Projekt-Vendim** “Për miratimin e ndihmës financiare për përbalimin e shpenzimeve të varrimit nga fondi Rezervë i Bashkisë”.
7. **Projekt-Vendim** “Për miratimin e ndihmës financiare për përbalimin e shpenzimeve të varrimit nga fondi Rezervë i Bashkisë”.
8. **Projekt-Vendim** “Për miratimin e pagës shpërblim kryetarët e fshatrave.”
9. **Projekt-Vendim** “Për miratimin e pagës shpërblim të këshilltarëve.”
10. **Projekt-Vendim** “Për miratimin e pagesës për anëtarët e këshillit Artistiko-Kulturor.”
11. **Projekt-Vendim** “Për miratimin e pagesës dhe shpenzimeve të K.S.Gramozi.”
12. **Projekt-Vendim** “Për miratimin e familjeve që përfitojnë nga programi social i strehimit “Subvencionimi i interesave të kredisë.”
13. **Projekt-Vendim** “Për miratimin e familjeve që do përfitojnë nga “Subvencionimi i Qirasë.”
14. **Projekt-Vendim** “Miratimin e procedurave për zbatimin e programit social të strehimit “përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese”, i financuar me fondet e buxhetit të shtetit.”
15. **Projekt-Vendim** “Për miratimin e dhënies titull qytetar nderi Z.Perikli Qirjazi”.
16. **Projekt-Vendim** “Për miratimin e listave në kullotat verore e livadhe dhe kullotave në pyje të ultë (cungishte) që kullohen për vitin 2026.”
17. **Projekt-Vendim** “Për miratimin e lidhjes së kontratës së shërbimit me postën Shqiptare sh.a., filiali Korçë, për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore.”
18. **Projekt-Vendim** “Për miratimin për shtesë fondi dhe shpërndarjen e fondeve buxhetore.”
19. **Projekt-Vendim** “Për miratimin për shtesë fondi dhe shpërndarjen e fondeve buxhetore.”
20. **Projekt-Vendim** “Për miratimin e dhenies në përdorim/qira të sipërfaqeve të fondit pyjor /kullor për agro-kultivim-përpunimi bimësh medicinale dhe frutore.”
21. **Projekt-Vendim** “Për dhënien e miratimit për dhënien në përdorim/qira të sipërfaqeve të fondit pyjor/kullor për ndërtimin e parkut fotovoltaik.”

22. **Projekt-Vendim** “Për dhënien e miratimit për dhënien në përdorim/qira të sipërfaqeve të fondit pyjor/kullosor për ndërtimin e parkut fotovoltai.”
23. **Projekt-Vendim** “Për dhënien e miratimit për dhënien në përdorim/qira të sipërfaqeve të fondit pyjor/kullosor për ndërtimin e parkut fotovoltai.”

**Protokolli i mbajtur sot më datë 27.01.2026 në mbledhjen e rradhës sipas njoftimit të dhënë në datën 22.01.2026.**

**Të pranishëm:** P.Risto, E. Xhelili, I.Milo, G.Tafili, P.Çunge, Z.Meto, S.Kodra, E.Avdi, S.Larti, H.Iljazi, I.Hodo,

**Mungon:** A.Tartari, B.Jashari, T.Çaçani, E.Çikopana, A.Zeneli.

E. Xhelili: Përshëndetje, fillojmë me mbledhjen e dates 27.01.2026 pika e parë e rendit të ditës. Jeni dakort me rendin e ditës?

Pro 9 Kundër 0 Miratohet

E. Xhelili: Ka dikush prej jush konflikt interesi me ndonjë nga pikat e rendit të ditës?

E. Xhelili: Nuk ka asnjë konflikt interesi.

E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën dy të rendit të ditës. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së dates 22.12.2025 të Këshillit Bashkiak dhe njohje me shkresën e zbardhjes së vendimeve nga institucioni i prefekturës.

E. Xhelili: Jeni dakort me pikën dy të rendit të ditës?

Pro 10 Kundër 0 Miratohet

E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën tre të rendit të ditës “Për miratimin e ndihmës ekonomike të familjeve që janë larguar nga sistemi i pikëzimit për muajin Dhjetor 2025, që nuk kanë marr pikët e mjaftueshme nga fondi i kushtëzuar për bllok ndihmën deri 6%.

E. Xhelili: Jeni dakort me pikën tre të rendit të ditës?

Pro 10 Kundër 0 Miratohet

E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën katër të rendit të ditës “Për miratimin e kriterëve për familjeve në nevojë që të trajtohen me ndihmë ekonomike nga përdorimi i fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar të bllok-ndihmës deri në 6%.”

E. Xhelili: Jeni dakort me pikën katër të rendit të ditës?

Pro 10 Kundër 0 Miratohet

E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën pesë të rendit të ditës “Për miratimin e raportit të vlerësimit dhe parashikimit afatmesëm të të ardhurave për PBA 2027-2029.”

E.Jorgji (Drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave): Në projekt-vendim është paraqitur raporti i vlerësimit dhe parashikimit afatmesëm të të ardhurave faktike për vitin 2024-2025 dhe sa është parashikimi për vitin 2026 dhe tre vitet e ardhshme 2027-2029.

Z.Meto: Unë e lexova projekt vendimin dhe po ta shikosh jeni në një linjë, 2024 me të njëjtën përqindje me 2025.

E.Jorgji: (Drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave): Në 2025 është rritur arkëtimi, por ndryshim plani nga 2024 kemi plani më i lartë në 2025, arsyeja e rritjes së planit është shtimi i kontratave për dhenien me qira të sipërfaqes së tokës që disa po taksohen dhe disa jo sepse nuk ju ka dal leja për punime dhe në pese subjekte qe kemi me qera, dy prej tyre taksohen.

Z.Meto: Kemi dhene shume sipërfaqe me qera duhet të ishin me të larta te ardhurat dhe e dyta me vendim këshilli rritja e taksave, funksioni me i mirë i bizneseve në krahasim me vitet e kaluara, 2027-2029 të ardhurat duhe të ishin me të larta në parashikim.

E.Jorgji: (Drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave): Arsyeja për mos taksimin e ketyre sipërfaqeve është mungesa e lejes që nuk ka dal nga ministria, 2027-2029 ecim parashikim e 2026 që është njësoj, ne mund të kemi rritje por nuk e ndryshon dot 3 vjecarin e ardhshëm sepse është i ngjashëm, vitin tjetër do kemi ndryshime të tjera sepse kështu funksionon miratimi të tre vjecarit.

I.Hodo: Sa është realizimi i të ardhurave për vitin 2025?

E.Jorgji: (Drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave) : Realizimi i të ardhurave për vitin 2025 është 71%.

I.Hodo: Kemi dhënë sipërfaqe toke pa fund me qera, është miratuar sipërfaqja nga Këshilli Bashkiak ka ardhur dhe konfirmimi nga ana e prefektit te qarkut pse nuk e takson.

E.Jorgji: (Drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave): Miratimin është dhënë për sipërfaqen me qera por nuk e taksohen sepse nuk mund të lidh kontratë pa i dal leja e ndërtimit në ministria.

I.Hodo: Do me thene ai atë prone e mban pezull as banorët nuk e shfrytëzojnë sa ai nuk e shfrytëzon.

H.Iljazi: Ai pronën mund ta pezullojë për 30 vite.

E.Jorgji: (Drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave): Nuk e pezullon dot për 30 vite sepse 5 vite mundësi.

P.Risto : Nëse brënda 5 vitesh ai nuk e zhvillon ate sipërfaqe atëherë prishet kontrata.

E. Xhelili: Jeni dakort me pikën pesë të rendit të ditës?

Pro 10 Kundër 0 Miratohet

E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën gjashtë të rendit të ditës “Për miratimin e ndihmës financiare për përballimin e shpenzimeve të varrimit nga fondi Rezervë i Bashkisë”.

E. Xhelili: Jeni dakort me pikën gjashtë të rendit të ditës?

Pro 10 Kundër 0 Miratohet

E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën shtatë të rendit të ditës “Për miratimin e ndihmës financiare për përballimin e shpenzimeve të varrimit nga fondi Rezervë i Bashkisë”.

E. Xhelili: Jeni dakort me pikën shtatë të rendit të ditës?

Pro 10 Kundër 0 Miratohet

E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën tetë të rendit të ditës “Për miratimin e pagës shpërblim kryetarët e fshatrave.”

H.Iljazi: Kryeplaku i fashatit Taç-Qëndër thotë që nuk jeton aty, kush duhet të meret me këto procedura, nëqofte se nuk është ai ku duhet të ankohen banorët e fshatit për një problem, zoteria në qoftë se do të jetë kryeplak të jetoj në fashat.

I.Hodo : Mendoj se duhet të mblidhen si fshat dhe pleqësia dhe nënpleqësisë që ka tre anëtarë të beni nje ankesë dhe ta paraqisni tek Sekretari i Këshillit, të shqyrtohet ankesa dhe të shkarkohet kryeplaku.

P.Riso: Bëhet kërkesa si fshat dhe me pas të shkarkohet.

E. Xhelili: Jeni dakort me pikën tetë të rendit të ditës?

Pro 10 Kundër 0 Miratohet

E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën nëntë të rendit të ditës “Për miratimin e pagës shpërblim të këshilltarëve.”

E. Xhelili: Jeni dakort me pikën nëntë të rendit të ditës?

Pro 10 Kundër 0 Miratohet

E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën dhjetë të rendit të ditës “Për miratimin e pagesës për anëtarët e këshillit Artistiko-Kulturor.”

E. Xhelili: Jeni dakort me pikën dhjetë të rendit të ditës?

Pro 10 Kundër 0 Miratohet

E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën njëmbëdhjetë të rendit të ditës “Për miratimin e pagesës dhe shpenzimeve të K.S.Gramozi.”

P.Çunge: Ky projekt-vendim është për tranjerët e moshave U-15, U-13, U-11, U-9 për grup moshat e vogla.

S.Larti: Në qoftë se mundeni duam një sqarim për këtë projekt-vendim.

K.Saliko: (Specialiste e Drejtorisë së Artit, Kulturës dhe Sportit ): Pagesës dhe shpenzimeve të K.S.Gramozi për të gjitha ekipet janë në total pesë trajnerë të cilet paguhen 17.000 lekë për 8 muaj.

S.Larti: Unë dua që të me sqaroni bazën ligjore për faktin që paguhen 8 muaj dhe a ka mundësi që këta trajnerë të paguhen për 12 muaj, pagesa me duket shume e ulet për 8 muaj.

K.Saliko: (Specialiste e Drejtorisë së Artit, Kulturës dhe Sportit): Në muajt e dimrit është afat pushimesh dhe për këtë arsye nuk paguhen.

S.Larti: Sipas një llogaritje që unë bera 17.000 lekë : 8 muaj një trajner merr rreth 2.200 lekë ne muaj, mendoj që të paguhen për 12 muaj dhe kjo pagesë të shkoj rreth 26.000 lekë.

K.Saliko: (Specialiste e Drejtorisë së Artit, Kulturës dhe Sportit ): Për tetë muaj që ata paguhen marin shtatëmbëdhjete mijë lekë të reja çdo muaj.

S.Larti: Në rregull atëherë jemi dakort.

E. Xhelili: Jeni dakort me pikën njëmbëdhjetë të rendit të ditës?

Pro 10 Kundër 0 Miratohet

E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën dymbëdhjetë të rendit të ditës “Për miratimin e familjeve që përfitojnë nga programi social i strehimit “Subvencionimi i interesave të kredisë.”

P.Çunga: Personat që kanë aplikuar janë të pa strehë.

E. Xhelili: Jeni dakort me pikën dymbëdhjetë të rendit të ditës?

Pro 10 Kundër 0 Miratohet

E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën trembëdhjetë të rendit të ditës “Për miratimin e familjeve që do përfitojnë nga “Subvencionimi i Qirasë.”

Z.Meto: Kriteret e qerasë i miratuam muajin e kaluar, jashë listës që ne na është paraqitur ka familje të tjera që kanë aplikuar dhe nuk kanë përfituar.

E.Dake: (Drejtor Drejtoria e Shërbimit Social): Jo lista është e njëjtë me vitin e kaluar vetem se është shtuar numri 16 që është kryefamiljare NE, pjesa tjetër janë të gjitha emrat që kanë qënë vitet e kaluara, vetem një emër është hequr nga lista e viteve te kaluar.

I.Hodo: Si funksionon vlerësimi i përfituesve?

E.Dake: (Drejtor Drejtoria e Shërbimit Social): Hapi i pare për zgjedhjen e listës, mblidhet komisioni i strehimit mblidhet dhe bën vlerësimin e dokumentacionit, te komisioni i strehimit bën pjesë Drejtori Juridik, Nënkryetari përkatës, Drejtori i Urbanistikës dhe stafi i Shërbimit Social. Kanë verifikuar të gjitha emrat bashkë me dokumentacionin si dhe me fotot bashkëngjitur dhe rezulton që ai person nuk duhet të trajtohet. Arsyen mund ta marrin te pjesa e komisionit me shkresë.

I.Hodo: Mund të aplikoj përsëri ky person?

E.Dake: (Drejtor Drejtoria e Shërbimit Social): Në qoftë se gjen një banesë për të jetuar po, por në qoftë se banesën e trajton për punë private jo.

Z.Meto: Ne po e miratojmë këtë listë por nëse listës i shkohen persona të tjerë do e miratojmë përsëri.

E.Dake: (Drejtor Drejtorja e Shërbimit Social): Patjetër që po.

E. Xhelili: Jeni dakort me pikën trembëdhjetë të rendit të ditës?

Pro 10 Kundër 0 Miratohet

E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën katërbëdhjetë të rendit të ditës “Miratimin e procedurave për zbatimin e programit social të strehimit “përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese”, i financuar me fondet e buxhetit të shtetit.”

Z.Meto: Listës që ne na është percjellë i janë shtuar dhe dy emra të tjerë, listat gjithsej ka 17 emra.

E.Dake: (Drejtor Drejtorja e Shërbimit Social): Po lista deri në një moment të dytë është më 17 emra. Në qofte se ne kemi emra të tjerë do futen në mbledhjen e radhës.

E. Xhelili: Jeni dakort me pikën katërbëdhjetë të rendit të ditës?

Pro 10 Kundër 0 Miratohet

E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën pesëmbëdhjetë të rendit të ditës “Për miratimin e dhënies titull qytetar nderi Z.Perikli Qirjazi”

I.Milo : Z.Perikli Qirjazi është profesor i nderuar për Kolonjën dhe për gjithë Shqipërinë.

H.Iljazi:Unë jam i propozimit që muajin tjetër doktor Z.Illir Milo në mbledhjen e radhës ti japet Titullit Qytetar Nderi i Kolonjës, ka shpëtuar jetë.

G.Tafili: Të bejmë një kërkesë si këshilltarë.

Z.Meto : Është diskutuar disa here për dhënien e Titullit Qytetar Nderi mjekut Z.Illir Milo, në mbledhjen e radhës kërkojmë si këshilltarë projekt- vendim për dhënien e Titullit Qytetar Nderi mjekut Z.Illir Milo.

E. Xhelili: Jeni dakort me pikën pesëmbëdhjetë të rendit të ditës?

Pro 10 Kundër 0 Miratohet

E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën gjashtëmbëdhjetë të rendit të ditës “Për miratimin e listave në kullotat verore e livadhe dhe kullotave në pyje të ultë (cungishte) që kullotën për vitin 2026.”

H.Iljazi: Kullotën duhet ta shfrytëzojnë si fillim rezidentët dhe më pas jo rezidentët.

E.Çuka: Gjithmonë ka funksionuar që kullotën e marrin si fillim rezidentet, çdo fermer ka mbi 10 vite që merr me qera të njëjten kullot.

Z.Meto: A ka kritere për dhenien e kullotës?

E.Çuka: Po ka kritere.

I.Hodo: Kemi bërë vitin e kaluar një kërkesë për kopetë e deleve shtegëtar që mos kalojnë në rrugë nacionale, por të vinë me kamion siç vinë deri në fshatin Petran të Përmetit.

P.Çunge: Në fshatin Borovë nuk lëne asnjë të mbjellë, çobenjtë zihen me banorët e fshatit.

Z.Meto: Ka një ligj le të zbatohet.

P.Çunge: Të kalojnë nëpër shtigje, jo nëpër rrugë automobilistike. Të merret vendim i këshillit bashkiak dhe policia bashkiake mos i lejojë që të dëmtojnë banorët e Kolonjës.

E. Xhelili: Jeni dakort me pikën gjashtëmbëdhjetë të rendit të ditës?

Pro 10 Kundër 0 Miratohet

E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën shtatëmbëdhjetë të rendit të ditës “Për miratimin e lidhjes së kontratës së shërbimit me postën Shqiptare sh.a., filiali Korçë, për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore.”

P.Risto: Pas lidhjes së kontratës qytetarët kanë mundësi ti paguajnë taksat e bashkisë edhe në postën Shqiptare.

E. Xhelili: Jeni dakort me pikën shtatëmbëdhjetë të rendit të ditës?

Pro 10 Kundër 0 Miratohet

E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën tetëmbëdhjetë të rendit të ditës “Për miratimin për shtesë fondi dhe shpërndarjen e fondeve buxhetore.”

Z.Meto: Pse do të përdoren këto fonde?

G.Duka: ( Drejtor Drejtorja e Finances): Drejtorja e Artit, Kulturës dhe Sportit i paraqet kryetarit të bashkisë Kolonjë, relacion për shtesë buxheti nga fondet e miratuara sipas shkresës nr.18059/15 dt. 24.12.2025 prot 7427 datë.30.12.2025 të Ministrisë së Financave, mbi zbatimin e aktit normativ nr 11, datë 19.12.2025 për shtesën e fondeve për njësitë e qeverisjes vendore në transfertën e pakushtëzuar, për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura. Vlera prej 3 377 192 lek do të përdoret për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të vitit 2024 dhe vitit 2025 e ndarë konkretisht në këtë mënyrë: Vlera 850 000 lekë do përdoret për shlyerjen e detyrimit të ngelur nga realizimi i eventit: Koncert "Pranverë", vlera 896 400 lekë do përdoret për shlyerjen e detyrimit për shpenzimet e kryera për mirëmbajtjen e Pallatit të Kulturës, vlera 1 300 000 lekë do të përdoret për shlyerjen e detyrimeve nga realizimi i eventit "Maratona Këngë Moj", dhe vlerën 330 792 lekë për shlyerjen e detyrimeve të krijuara nga realizimi i eventit "Kolonja e Piktoreve të Vegjël".

E. Xhelili: Jeni dakort me pikën tetëmbëdhjetë të rendit të ditës?

Pro 10 Kundër 0 Miratohet

E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën nëntëmbëdhjetë të rendit të ditës “Për miratimin për shtesë fondi dhe shpërndarjen e fondeve buxhetore.”

G.Duka: ( Drejtor Drejtorja e Finances): Drejtorja e Shërbimit Social, Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve i paraqet kryetarit të bashkisë Kolonjë relacion për shtesë buxheti nga fondet e miratuara sipas shkresës nr.18133/1 prot datë.24.12.2025 të Ministrisë së Financave, mbi “Detajimin e fondit të grantit të performancës për bashkitë për vitin 2025” nëpërmjet kësaj shkrese, ju paraqesim kërkesën që vlera prej 8, 777,636.18 lekë të përdoret për zgjerimin e kapaciteteve infrastrukturore të godinës ekzistuese të kopshtit "Marie Gjergo", që funksionon nën administrimin e Bashkisë Kolonjë. Kopshti aktualisht disponon klasa mësimore dhe kuzhinë funksionale, por për shkak të rritjes së ndjeshme të numrit të fëmijëve që frekuentojnë kopshtin me shërbim ushqimi (drekë), kapacitetet ekzistuese nuk janë më të mjaftueshme për përballimin e nevojave reale të komunitetit. Në këtë kuadër, paraqitet nevoja për realizimin e ndërhyrjeve të mëposhtme, zgjerim të hapësirave ekzistuese dhe shtesë ndërtesë, zvendësimin e kaldajave ekzistuese me kaldaja të reja, zgjerim të ambientit të mensës, ndërtim të një kati shtesë për klasa mësimore dhe ambiente sanitare, krijimin e një klase burimore për fëmijët me aftësi të kufizuara (AK). Drejtorja e Arsimit i paraqet kryetarit të Bashkisë Kolonjë relacion për shtesë buxheti nga fondet e miratuara sipas shkresës nr.18133/1 prot datë.24.12.2025 të Ministrisë së Financave, mbi “Detajimin e fondit të grantit të performancës për bashkitë për vitin 2025”, ju paraqesim kërkesën që vlera prej 5,101,123.60 lekë të përdoret për ndërtimin e një këndi lojrash modern, të sigurt dhe funksional në lulishten kryesore të qytetit. Lulishtja ndodhet në afërsi të dy shkollave shkolle 9- vjeçare “P.K.Negovani” dhe gjimnazit “ P.N.Luarasi ” Ersekë duke e bërë këtë investim të rëndësishëm për komunitetin lokal. Për vite me radhë, fëmijët e kësaj zone kanë pasur mungesë të theksuar të hapësirave të dedikuara për lojë dhe argëtim, çka e bën këtë projekt një domosdoshmëri sociale dhe urbane,e cila do të funksionojë nën administrimin e Bashkisë Kolonjë. Qëllimi kryesor i projekti është krijimi i një ambienti të përshtatshëm për zhvillimin fizik, emocional dhe social të fëmijëve. Përmes ndërtimit të këtij këndi lojrash, bashkia synon të ofrojë një hapësirë ku fëmijët mund të luajnë të sigurt, të socializohen dhe të zhvillojnë aftësi të reja jashtë mjedisit shkollor. Këndi i lojrave do të ndërtohet në lulishten e qytetit, një zonë e

gjelbëruar dhe lehtësisht e aksesueshme nga familjet. Afërsia me institucionet arsimore e bën këtë vendndodhje strategjike dhe funksionale për përdorim të përditshëm nga nxënësit pas orarit mësimor. Projekti parashikon ndërtimin e disa zonave funksionale loje, të ndara sipas grupmoshave. Do të instalohen pajisje multifunksionale si rrëshqitëse, lëkundëse, struktura ngjitjeje, shtëpiza loje dhe hapësira kreative. Të gjitha pajisjet do të jenë të certifikuara sipas standardeve europiane për sigurinë e fëmijëve. DysHEMEJA do të jetë prej gome ekologjike anti-rrëshqitëse, ndërsa zona do të pajiset me ndriçim publik dhe kamera sigurie. Ndërtimi i këtij këndi lodrash do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë pozitiv në komunitet, duke ofruar një hapësirë të përbashkët për argëtim dhe socializim. Projekti forcon lidhjet komunitare dhe nxit një stil jetese aktive për fëmijët. Krijimi i një terreni sportiv pranë shkollës ndikon në përmirësimin e mësimdhënies dhe të nxënit. Qëllimi i këtij projekti është të restaurojë terrenin sportiv në shkollë, të hartojë një strategji dhe të ngrejë fondet për të ndërtuar një mjedis që synon konkretizimin e lëndës së edukimit fizik. Ky projekt do të ndikojë në rritjen e cilësisë së mësimdhënies e të nxënit dhe do ketë impakt pozitiv në regjistrimin e nxënësve në shkollë dhe Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit i paraqet kryetarit të Bashkisë Kolonjë relacion për shtesë buxheti nga fondet e miratuara sipas shkresës nr.18133/1 prot datë.24.12.2025 të Ministrisë së Financave, mbi “Detajimin e fondit të grandit të performancës për bashkitë për vitin 2025”, ju paraqesim kërkesën që vlera prej 2,000,000 lekë e fituar nga granti i performancës ta përdorim për hartimin e Planeve të mbarështrimit pasi nga ana jonë si drejtori e kemi objektiv për sigurimin e druve të zjarrit për popullatën si dhe investime të ndryshme. Planet e Mbarështrimit të ekonomive pyjore na sigurojnë një menaxhim të planifikuar dhe të qëndrueshëm të fondit pyjor, duke u bazuar në të dhënat të sakta mbi strukturën përbërjen dhe gjëndjen e pyllit. Nëpërmjet këtyre planeve përcaktohen masat kulturore të nevojshme, ritmin e shfrytëzimit dhe ndërhyrjet përmirësuese në përputhje me kapacitetin prodhues të ekosistemit pyjor. Gjithashtu planet shërbejnë si instrument ligjor dhe teknik për kontrollin, monitorimin dhe vlerësimin afatgjatë të zhvillimit të fondit pyjor.

E. Xhelili: Jeni dakort me pikën nëntëmbëdhjetë të rendit të ditës?

Pro 10 Kundër 0 Miratohet

E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën njëzet të rendit të ditës “Për miratimin e dhënies në përdorim/qira të sipërfaqeve të fondit pyjor /kullozor për agro-kultivim-përpunimi bëmësh medicinale dhe frutore.”

H.Iljazi: Investime të këtij lloji i sjellin të ardhura Kolonjës.

E. Xhelili: Jeni dakort me pikën njëzet të rendit të ditës?

Pro 10 Kundër 0 Miratohet

E.Xhelili: Kemi dhe tre projekt vendime shtesë ne rendin e ditës, vazhdojmë me pikën njëzet e një të rendit të ditës “Për dhënien e miratimit për dhënien në përdorim/qira të sipërfaqeve të fondit pyjor/kullozor për ndërtimin e parkut fotovoltaik.”

E. Xhelili: Jeni dakort me pikën njëzet e një të rendit të ditës?

Pro 9 Kundër 0 Abstenim 1 Miratohet

E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën njëzet e dy të rendit të ditës “Për dhënien e miratimit për dhënien në përdorim/qira të sipërfaqeve të fondit pyjor/kullozor për ndërtimin e parkut fotovoltaik.”

E. Xhelili: Jeni dakort me pikën njëzet e dy të rendit të ditës?

Pro 9 Kundër 0 Abstenim 1 Miratohet

E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën njëzet e tre të rendit të ditës “Për dhënien e miratimit për dhënien në përdorim/qira të sipërfaqeve të fondit pyjor/kullosor për ndërtimin e parkut fotovoltaik.”

E. Xhelili: Jeni dakort me pikën njëzet e tre të rendit të ditës?

Pro 9 Kundër 0 Abstenim 1 Miratohet

**Proces-Verbali i datë 27.01.2026 është firmosur nga 10 anëtarë Këshilli.**

**SEKRETAR I KËSHILLIT**

**INSUIDA ORHANAS**



**KRYETAR I KËSHILLIT**

**ERALDO XHELILI**

